RAPORTI FINAL

I VLERESIMIT TE JASHTEM

PER
AKREDITIMIN E PROGRAMIT
TE CIKLIT TE PARE BACHELOR NE JURIDIK

Institucionit "Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë"

Ekspert i vleresimit:

Prof. Dr. Aurela Anastasi

Tiranë, Korrik 2015

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit BSc Juridik

HYRJE

ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM PROGRAMIT TË STUDIMIT

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë ka ofruar programin e studimit në degën e Drejtësisë, në nivelin Bachelor, me një kohëzgjatje tre-vjeçare. Ky program është hapur për herë të parë në këtë Shkollë, ne vitin akademik 2012-2013. Aktualisht, po përfundon viti i tretë i studimeve të këtij programi.

Program Studimi i Ciklit të Parë në: **Shkenca Juridike dhe Politike**

Kohëzgjatja/sistemi i studimit: **3 vite akademike-me kohë e plotë**

Emërtimi i Diplomës: **Bachelor në Juridik**

Misioni dhe qëllimet e këtij programi janë të përcaktuara nëkuadrin e të gjithë shkollës së arsimit të lartë dhe integrohen me Misionin dhe qëllimet e të gjitha programeve. Ato paraqiten afatshkurtra dhe afatgjata dhe shkurtimisht, mund të grupohen si vijon:

- Promovimi i zhvillimit të kulturës dhe të shkencës, nëpërmjet mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe bashkëpunimit akademik;
- Formimi profilizues i studentëve, zhvillimi dhe transmetimi i dijeve, nëpërmjet instrumenteve klasike dhe instrumenteve të tjera akademiko-didaktike;
- Formimi i specialistëve në fushën e Drejtësisë, në përputhje me kërkesate tregut të punës, të aftë për të përballur sfidat aktuale të zhvillimit të vendit dhe rajonit;
- Planifikimi strategjik për projektimin në të ardhmen e ciklit të tretë të studimeve universitare.

Programi Bachelor që paraqitet këtu objekt vlerësimi është i integruar në misionin dhe qëllimet e të gjithë shkollës, si dhe dallohet prej tyre nëpërmjet misionit, qëllimeve dhe objektivave tëveçanta, të cilat mund të grupohen si vijon:

- Programi i drejtësisë aspiron të përmbushë misionin e tij arsimor nën frymën e lirisë dhe të respektit, të dinjitetit human, pluralizmit të ideve, transparencës së procedurave si dhe promovon formimin e mendimit të lirë të studentëve, duke u siguruar mundësi të barabarta.
- Përvetësimi i kulturës ligjore bazë, kombëtare, evropiane dhe ndërkombëtare;

- Thellimi i njohurive që lejojnë vlerësimin e instituteve e parimeve të së drejtës pozitive dhe tëkapacitetit interpretuese: nëpërmjet teknikave dhe metodologjive kazuistike (kazuse).
- Të përcjellë njësens më të lartë të kulturës juridike dhe etikës, duke u përqëndruar në parime/sjellje institucionale juridike, që kanë në fokus të tyre zbatimin dhe respektimin e ligjit dhe luftën kundër shkeljeve ligjore.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

- Përbërja e GVJ:
  - Prof. Dr. Aurela Anastasi

<u>Vlerësimi sipas Standardeve</u>

Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve[1]
I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE **Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.**	
Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit; **Kriteri 4** Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit; **Kriteri 5** Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës; **Kriteri 6** Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.	3.Vlerësoj se programi i studimeve në degën e drejtësisëështë hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimet e institucionit në këtë fushë, si dhe harmonizohet mirë me misionin dhe qëllimet e Shkollës së Lartë në përgjithësi, të të gjitha degët e studimit që ajo ofron. 4.Objektivat e studimit në ciklin e parë të studimeve dega drejtësi, janë të qarta dhe janë të përshtatura me kërkesat dhe sfidat aktuale që duhet të përballojnë studentët e drejtësisë, me qëllim që të aftësohen për tregun e punës. 5. Objektivat kanë mbajtur në vëmendje formimin e studentëve me një kulturë të përgjithshme juridike dhe ka një profilizim të lehtë në kulturën juridike evropiane, që e dallon disi këtë program nga programe të tjera homologe. Kjo e përshtat studentin me tregun e madh të punës dhe e aftëson atë, për të ndjekur më lehtë proceset e integrimit në BE. 6. Programi ndjek vijat kryesore të programeve të tjera akademike të ciklit të parë të studimeve, që janë vlerësuar si të përshtatshme në kuadrin e zhvillimit ekonomik të vendit.
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit; **Kriteri 2** Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të	1. Programi duket i përshtatur me strategjinë për zhvillimin e institucionit. Vihet re një lidhje logjike midis përmbajtjes së programit dhe objektivave strategjike të institucionit. Midis tyre veçojmë konsolidimin e degës së drejtësisë nëpërmjet zhvillimit të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.

[1] GVJ duhet të shprehen me shkrim për të gjitha standardet (bazuar në kriteret përkatëse). Në fund të çdo rubrikegrupi duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardit në tërësi.

përgjithshme; **Kriteri 3** Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;	Bashkëpunimi akademik me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit; bashkëpunimi me komunitetin e studentëve dhe hapja rrugë e ciklit të dytë dhe të tretë të studimit në këtë fushë. Formalisht, ky program studimi që ofrohet është i aftë që të përshtatet me këto objektiva të zhvillimit strategjik. 2. Vlerësoj se programi i paraqitur, duke përfshirë edhe syllabusine lëndëve, krijojnë mundësinë që studentët e drejtësisë të përgatiten me njohuri të përgjithshme, bazë juridike. KY konkluzion mund të testohet nga grupet e lëndëve të ofruara dhe nga spjegimet e sillabuseve të lëndëve. Nëpërmjet lëndëve, bazë teorike, të cilat janë të përfshira në program bëhet e mundur që studentët të përvetësojnë parimet bazë të shtetit ligjor dhe njohuritë bazë në të tria fushat kryesore të së drejtës, Publike, Penale e Civile. Vlerësoj se pavarësisht nga njohuritë e tjera të kulturës juridike që studentët marrin me lëndët fakultative, korpusi qendror ilëndëve bazë juridike është prezent dhe është i detyrueshëm, pra që frekuentohet nga të gjithë studentët. 3. Kjo pikë është e realizueshme, pasi program mësimor përmbush disa kritere që e lejojnë çdo program të ciklit të parë të studimeve të drejtësisë të krijojë shprehi të veçanta. Kjo, realizohet veçanërisht në fushën e studimeve të së drejtës evropiane. Gjithashtu, përvetësimi I gruplëndëve të historisë dhe teorisë juridike, I mundësojnë studentëve të përshtaten me shprehi të veçanta në cilindo prej profesioneve që mund të punojë në të ardhmen, këtë fushë. Sidoqoftë, KY konkluzion arrihet përmes një vlerësimi të përgjithshëm krahasimor, me kurrikulat e fakulteteve të tjera të drejtësisë, Brenda dhe jashtë vendit. Nuk ka ndonjë studim empirik për këtë çështje, jo vetëm nga ky subjekt, por as edhe nga ndonjësubjekt tjetër.
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE **Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.**	
Kriteri 1 Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar; **Kriteri 2** Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin: a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar; b. kërkesat e punëdhënësve; c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.	1. Disa konsiderata të përgjithshme janë dhënë edhe në tabelën I. Vlerësimin tim se ky program studimi synon të plotësojë nevojat e tregut të punës, në përputhje me zhvillimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar e mbështes: a. Karakteri i përgjithshëm i programit, që I qaset të gjitha aspekteve të tregut të punës për juristët; b. Ekzistenca si lëndë të detyrueshme e Corpusit të lëndëve bazë. c. Intensifikimi I njohurive dhe kulturës së përgjithshme teoriko-juridike të Drejtësisë; d. Intensifikimi i lëndëve që japin njohuri për të drejtën evropiane; e. Përfshirja në syllabuse e njohurive për të drejtën evropiane. 2. Studimi i tregut është kryer mbi bazën e të dhënave zyrtare që ofrojnë institucionet, si dhe studimeve të tjera. Këtu përfshihen të dhënat e INSTAT mbi kërkesat e tregut për punësim, sipas profilit që ofrohet; anketa dhe sondazhe mbi

	kërkesat e punëdhënësve; të dhënat e MAS për fluksin e maturantëve drejt IAL publike dhe jo publike; programet e ofruara nga IAL publike dhe jopublike konkurrente, ne rajon e Mesdhe; rezultatet e tyre në punësimin e studentëve përkatës në dy vitet e para mbas diplomimit. Programi Kombëtar i Intershipit paraqitur nga Qeveria si një mundësi afatshkurtër punësimi edhe për studentët e nivelit Bachelor. Gjykoj se studimi i kryer ofron një ide të arsyeshme në lidhje me kriteret e parashikuara në pikën 2 të tabelës II. Sidoqoftë, mbahet parasysh fakti se tregu I punës për jurist është mjaft I gjerë, por është rritur disafish numri I të diplomuarve në drejtësi, për shkak të rritjes së numrit të institucioneve të arsimit të lartë në drejtësi, pa u bazuar mirë, apo në bazë të një studimi, në kërkesat e vendit për këto institucione.
Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.	
Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare; **Kriteri 2** Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.	1. Ky program studimi është në përputhje me interesat kombëtare të vendit. Si cikël i parë i studimeve, ky program formon të rinj me njohuri juridike, mbi shtetin e së drejtës, mbi demokracinë dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të Njeriut, të cilët mund të shërbejnë, veçanërisht në administratën gjyqësore, ose në tregun privat. Mbi të gjitha ata janë të gatshëm të ofrojnë ndihmesën e tyre për edukimin ligjor të publikut në tërësi, nëse do të ketë një strategji të tillë. 2. Currila e hartuar synon ruajtjen e vlerave kombëtare, pasi ofron mundësi për të njohur thellësisht historinë dhe evolucionin e të drejtës shqiptare. Syllabuset e ofruara, krijojnë mundësi për të dimensionuar njohuritë e studentëve, mbi të drejtën e brendshme, me njohuritë e të drejtës ndërkombëtare klasike dhe të drejtës evropiane.

<u>Konkluzione të GVJ:</u>

Objektivat e studimit në ciklin e parë të studimeve dega drejtësi, janë të qarta dhe janë të përshtatura me kërkesat dhe sfidat aktuale që duhet të përballojnë studentët e drejtësisë, me qëllim që të aftësohen për tregun e punës. Ato mbajnë në vëmendje formimin e studentëve me një kulturë të përgjithshme juridike që i aftësojnë ata në përballjen me sfidat e zhvillimit ekonomik të vendit.

Programi i paraqitur, duke përfshirë edhe syllabusin e lëndëve, krijon mundësinë që studentët e drejtësisë të përgatiten me njohuri të përgjithshme, bazë juridike. Nëpërmjet lëndëve, bazë teorike, të cilat janë të përfshira në program bëhet e mundur që studentët të përvetësojnë parimet bazë të shtetit ligjor dhe njohuritë bazë në të tria fushat kryesore të së drejtës, Publike, Penale e Civile. Korpusi qendror ilëndëve bazë juridike është present dhe është I detyrueshëm, pra që frekuentohet nga të gjithë studentët.
Programi i studimit synon të plotësojë nevojat e tregut të punës, në përputhje me zhvillimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar e mbështetëse. Studimi i tregut është kryer mbi bazën e të dhënave zyrtare që ofrojnë institucionet, si dhe studimeve të tjera, të cilat janë vetëm orientuese.

Programi synon ruajtjen e vlerave kombëtare, pasi ofron mundësi për të njohur thellësisht historinë dhe evolucionin e të drejtës shqiptare. Syllabuset e ofruara, krijojnë mundësi për të dimensionuar njohuritë e studentëve, mbi të drejtën e brendshme, me njohuritë e të drejtës ndërkombëtare klasike dhe të drejtës evropiane.

2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Tregues të matshëm:

- ☑ Fakulteti, Organizimi hierarkik i Fakultetit
- ☑ Organet e zgjedhura në të gjitha nivelet
- ☑ Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

3. Personeli akademikdhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Tregues të matshëm:

- ☑ Struktura didaktike (seksionet) për departamentetose programin e studimit
- ☑ Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, (Tabelat 1- 2, të cilat mund të plotësohen edhe nga verifikimi i tabelave të pasqyruara në RVB)

Tabelat 1-2

Tabela 1

Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Politike Departamenti Juridik							
Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)		Detyra në Dep.	Titulli /Grada	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)		Titulli /Grada	Institucioni ku punon full time
1	Alketa Elezi	Anëtar	Prof.As.	1	Albana Shtylla	MA	Kuvendi i Shqipërisë
2	Redi Shtino	Anëtar	Student i Dokt.	2	Juliana Latifi	Prof.As.	TBU
3	Merita Malile	Anëtar	St. i dokt.	3	Anisa Angjeli	Dr.	UT

4	Arjan Gjini	Anëtar	St. I Dokt.	4	Iris Petrela	Dr.	UT
5	Arben Prifti	Anëtar		5	Erjon Lushaj	St. I dokt.	Praktikë Private
6	Luljeta Kodra	Shef	Dr.	6	Ilidiona Malollari	Ma	Praktikë Private
7	Roland Dodani	Anëtar	Dr.	7	Inva Cela	Ma	Praktikë Private
8	Erina Caka	Anëtar	Ma				
9	Irida Danaj	Anëtar	Ma				

Tabela 2

IAL	**Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Politike Departamenti Juridik**							
	Numri i PAE		Numri i PAK		Numri i PA		Në Total	
	Gj	Tituj/ Grada	Gj	Tituj/ Grada	Gj	Tituj/ Grada	Gj	Tituj/ Grada
Fakulteti Shkencave Juridike dhe Politike	1	Prof.As	1	Prof			1	Prof
	6	PhD/Dr.	1	Prof.As			2	Prof.As
	2	MSc/MP	3	PhD/Dr.			9	PhD/Dr.
			2	MSc/MP			4	MSc/MP
Në total	9		7				16	

☑ Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (Tabela3)

Tabela 3

	Departamenti Juridik		
	PAE	PAK	Raporti PAE/PAK
Profesorë		1	
Profesorë të As.	1	1	
Doktorë	6	3	
Pedagogë (pa tituj)			
Asistentë me Ma	2	2	

Asistentë pa Ma			
Personeli Administrativ	7		

☑ Të dhënat sipas seksit **Tabela 4**

Titulli	**Departamenti Juridik**		
	PAE femra	PAE Meshkuj	Raporti M/F
Profesorë			
Profesorë të As.	1		
Doktorë	2	4	
Pedagogë (pa tituj)			
Asistentë me Ma	2		
Asistentë pa Ma			
Personeli Administrativ	6	1	

☑ Të dhëna sipas moshës së personelit **Tabela 5**

Personeli sipas titujve /gradave	Numri i Personelit Akademik Efektiv dhe administrativ me moshë:					
	(25-35)	(36-45)	(46-55)	(56-65)	(66-68)	(69-75)
Profesorë						1
As. Prof		2			1	
Doktorë	4	7	1	1		
Pedagogë (pa tituj)						
Asistentë me Ma	4	1	2			
Asistentë pa Ma						
Personeli Administrativ						

Tabela 6

Personeli sipas titujve /gradave	Numri i Personelit Akademik me Kontratë me moshë:					
	(25-35)	(36-45)	(46-55)	(56-65)	(66-68)	(69-75)
Profesorë		1				
As. Prof		1	2	1		
Doktorë	2	2	1			

Pedagogë (pa tituj)						
Asistentë me Ma	5		1			
Asistentë pa Ma						

- ☑ Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat
- ☑ Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë
- ☑ Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
III - PERSONELI I INSTITUCIONIT **Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.**	
Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren; **Kriteri 2** Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë; **Kriteri 3** Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit; **Kriteri 4** Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.	Rekrutimi i personelit është kryer në përputhje me statutin dhe nenet 25,26 dhe 27 të rregullores. Janë ndjekur dhe respektuar procedurat ligjore në rekrutimin e personelit. Kërkesat për personel akademik me kohë të plotë apo me kohë të pjesshme, janë publikuar on-line në faqen zyrtare të SHLP "Mesdhetare" të Shqipërisë, në median elektronike dhe të shkruar.Vlerësimi paraprak i kërkesave të paraqitura, intervistimi i kandidatëve dhe paraqitjae propozimit për miratim Rektorit, përbëjnë disa nga detyrat e Komisionit të ngritur nga Rektori. Personeli akademik me kohë të plotë përbën 70% të personelit akademik të angazhuar. Një nga metodat e vlerësimit të stafit akademik është marrja pjesëe një komisioni ad-hoc deri në dy herë në vit në orë mësimi.Sipas shpjegimeve në raportin e vlerësimit të brendshëm dhe intervistave që zhvilluam, u theksua se, ky komision i ngritur nga Dekani paraqet përmes një raporti problemet e konstatuara dhe rekomandon marrjen e masave përkatëse. Pas kryerjes së një ballafaqimi nga Dekani me pedagogun e vlerësuar, merren masat e nevojshme. Gjithashtu, u theksua se kontrolli i pedagogeve kryhet edhe përmes anketimeve te studenteve, te cila kryhen çdo vit akademik. Kjo metodë e kontrollit të mësimdhënies me komision ad hoc, harmonizohet edhe me vlerësime te tjera, si numri i artikujve kërkimorë të botuar, pjesëmarrja në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, publikime të tjera, rezultateve të formave të vlerësimit të plotësuara nga studentët në lidhje me performancën e pedagogëve, etj. Institucioni disponon një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, njoftimeve për

	punë.
Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.	
Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit; **Kriteri 2** Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ; **Kriteri 3** Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik; **Kriteri 4** Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore "Doktor„ ose titullin akademik "Docent„.	Në zyrën e burimeve njerëzore, Sekretarinë Mësimore dhe në njësinë bazë dhe atë kryesore të institucionit disponohet një bazë e hollësishme të dhënash për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit. Departamenti disponon listën e plotë të personelit akademik dhe të personelit ndihmës të angazhuar për secilin semestër të vitit akademik. Kjo listëështë publikuar edhe në faqen zyrtare on-line të SHLP Mesdhetare të Shqipërisë. Vlerësoj se është pjesë e rëndësishme e procesit transparent të rekrutimit, publikimi nga ky institucion i kritereve dhe procedurave të rekrutimit të personelit. Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore "Doktor„ ose titullin akademik "Docent„. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në ciklin e parë të studimeve Bachelor ka në përbërje të tij pedagogë me titullin prof as, doktor dhe doktor ne proces. Megjithatë, ka disa pedagogëefektive që janë ende në procesin e kualifikimit shkencor. Një nga konkluzionet qënxorëm nga intervistimet e studentëve ishte se efektiviteti i më i lartë për transmetimin e njohurive në raport me ta arrihej nga pedagogë që ushtronin edhe profesionin në praktikë, veçanërisht nga pedagogët avokatë.
Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.	
Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore; **Kriteri 2** Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë; **Kriteri 3** Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).	Studentëve u vihet në dispozicion laboratori i Informatikës dhe sistemi audio-viziv në çdo sallë ku zhvillohen leksione dhe seminare. Vlerësoj se institucioni realizon praktikat profesionale të studentëve nën mbikëqyrjen e personelit mësimdhënës, me raportin tutor/student përafërsisht 1/10. Edhe studentët dëshmuan në intervistime se kanë kryer praktikë mësimore efektive. Ata vlerësuan si përvojë pozitive edhe ndjekjen e diskutimin e seancave gjyqësore gjatë zhvillimit të vitit akademik.

Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.	
Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor; **Kriteri 2** Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.	Për të përmbushur këtë qëllim, institucioni ka përdorur disa forma si: a)Mbështetje financiare e pedagogëve dhe punonjësve shkencorëpër të marrë pjesë në udhëtime studimore në universitete dhe institucione të tjera të huaja; b)Nxitje e pjesëmarrjes së pedagogëve dhe punonjësve shkencorë në zbatimin e projekteve kërkimore-shkencore të financuara nga universitete dhe institucione të tjera; c)Financimi i botimeve të pedagogëve dhe punonjësve shkencorë nga UMSH Press ose ente të tjera botuese, brenda dhe jashtë vendit; d) Nxitje e stafit akademik për botimin e artikujve shkencorë në gjuhën shqipe dhe të huaj, në revistën me Bord Shkencor EUROMEDITERRANEAN si dhe në revista të tjera; e) përcaktimi i marrjes së titujve dhe gradave shkencore si një detyrë në kontratën e punës së pedagogëve; f) mospërmbushja e objektivave të kualifikimit shkencor shoqërohet me masa administrative, kryesisht mos rinovimi ; Programet e studimit mund te gjenden në rrugë elektronike në faqen zyrtare www.umsh.edu.al; FB, ato janë të afishuara në hollin e godinës dhe mund të gjenden gjithashtu në Info Point. Informacion në lidhje me programet e studimeve mund të merret gjithashtu pranë çdo departamenti.

Konkluzione të GVJ:

Janë ndjekur dhe respektuar procedurat ligjore në rekrutimin e personelit. Procedurat e rekrutimit dhe kriteret e tij janë tëpërcaktuara në Rregulloren Organizative të institucionit.
Midis anëtarëve të stafit akademik, ka pedagogëtë kualifikuar me eksperiencë, ka pedagogë me tituj shkencorë, prof.as dhe doktorë, ka avokatë me eksperiencë, pedagogë që kanë kryer studimet në universitete serioze jashtë vendit. Megjithatë, ka edhe pedagogë të rinj, të cilët ende nuk kanë krijuar një qëndrueshmëri, por janë në proces kualifikimi.

Ka një proces të kontrollit të mësimdhënies në auditor, por nuk ka një raport ku mund të arrijmë në konkluzione se cilat kanë qenë problemet e konstatuara gjatë këtyre kontrolleve. Ndërkohë, ka përpunime të rezultateve nga përpunimi i pyetësorëve nga studentët. Mbetet të përforcohet bashkëveprimi i metodave të ndryshme të mbikëqyrjes së personelit akademik, sipas përshkrimit që kemi dhënë më sipër.

Shkolla disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara, e cila është e aksesueshme on line, si edhe pranë departamenteve.

4. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, rezidencat.

Tregues të matshëm:

☑ Mjediset për Programin e studimit

- Salla për leksione
- Klasa për seminare
- Salla për aktivitete promovuese
- Salla për praktikë lëndore/ profesionale
- Laboratorë për lëndët
- Laboratorë informatike
- Salla interneti
- Salla për bibliotekë
- Mjedis për fotokopjime, librari etj
- Zyrë informacioni për studentët
- Nyje hidrosanitare

Të dhëna sasiore për infrastrukturën në funksion të Programit të Studimit Bachelor në Juridik

☑ Mjediset për stafin:

- Mjedise për Dekanin/ kancelarin
- Zyra për sekretarinë mësimore
- Zyra për departamentet/qendrat kërkimore
- Zyra për personelin akademik

Të dhëna sasiore për infrastrukturën në funksion të Programit të Studimit Bachelor në Juridik dhe mjediset për stafin

Tabela 7

Mjediset të SHLP Mesdhetare e Shqipërisë	**Sasia**	**Sipërfaqja**	**Norma m²/për student**
Salla për leksione	7	558.2 m²	
Klasa për seminare	11	398.4 m²	
Salla për aktivitete promovuese	1	104 m²	
Laboratorë informatike	1	46.4 m²	
Salla interneti	1	46.4 m²	
Salla për bibliotekë	1	107 m²	
Mjedis për fotokopjime, librari etj	1	35.2 m²	
Zyrë informacioni për studentët	1	37.6 m²	
Korridore/holle	12	748.2 m²	

Nyje hidrosanitare për studentët	31	132 m²	
Nyje hidrosanitare për personelin akademik	13	48.5 m²	
Mjediset për stafin:	**Sasia**	**Sipërfaqja**	**Norma m²/për person**
Zyra për Rektoratin	7	484.6 m²	
Zyra për sekretarinë mësimore	1	37.6 m²	
Zyra për departamentet/qendrat kërkimore	2	20 m²	
Zyra për personelin akademik	6	103.9 m²	
Zyrë për financën	1	9 m²	
Zyrë për Njësinë e SBC	1	14 m²	
Salla për mbledhje	1	54 m²	
Mjedis për stafin e shërbimit	2	31.2 m²	
Mjedise shlodhëse si kafeteri/ fastfood/ restorant	1	120 m²	
Totali		**3056 m²**	**Për studentët e programit të studimit Bachelor në Juridik, raporti është rreth 1/9** m²

☑ Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

<u>Vlerësimi sipas Standardeve</u>

Standardet/kriteret	**Përmbushja e standardeve**
V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI **Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.**	
Kriteri 1 Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore; **Kriteri 2** Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit; **Kriteri 3** Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit; **Kriteri 4** Përgjegjësit e programit hartojnë	Institucioni ka siguruar një literaturë të pasur, në ndihmë të studentëve, në Bibliotekën e SHLP Mesdhetare e Shqipërisë. Biblioteka dhe salla e studimit ndodhet në katin përdhes të godinës së Universitetit dhe është lehtësisht e aksesueshme për studentët.Literatura i ndihmon studentët për të realizuar objektivat e programeve të studimit. Biblioteka ka punonjëset përkatëse, si dhe bazën kompjuterike. Studentët kanë akses të fotokopjojnë në bibliotekë. Nga intervistat u konstatua se ka nevojë që punonjëset e bibliotekës dhe pedagogët e Shkollës duhet të kenë njohuri për respektimin e të drejtës së autorit. Për këtë, është e nevojshme që

një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të; **Kriteri 5** Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.	tëparashikohen disa rregulla për të drejtën e autorit në Rregulloren që ata disponojnë. U konstatua në vend, se ambientet e bibliotekës janë shumë bashkëkohore dhe plotësisht higjienike SHLP ka mbështetur me fonde monetare të nevojshme për pasurimin e bibliotekës me tituj të rinj. Numërohen 1600 tituj tëndryshëm të fushës së jurisprudencës, në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj. Janë libra të karakterit fondamental shkencor, botime të mendimit alternativ, si dhe të profileve të shkollave të ndryshme të kulturës juridike. Librat janë të ndara në rubrika:E drejtë publike;E drejtë private;E drejtë administrative;E drejtë civile;E drejtë penale;Procedurë civile;Procedurë penale;Komentarë të ndryshëm mbi të drejtën; Për blerjen e literaturës së specializuar në fushën e kërkimit shkencor, SHLP Mesdhetare e Shqipërisë në bashkëpunim me përgjegjësin e programit alokon çdo vit një fond, i cili ndryshon sipas kërkesave te departamenteve. Pasurimi i bibliotekës me libra dhe autorë të rinj sigurohet edhe nga burime të tjera. Kështu, biblioteka është pasuruar me dhurime librash nga OSBE, Banka Botërore, Kuvendi i Shqipërisë dhe Fondi Shqiptaro Amerikan. Shërbimi i internetit ofrohet edhe në sallën e bibliotekës ku lehtësisht mund te navigohet. U konstatua në vend se orari i punës së Bibliotekës është shpallur dhe është përshtatur gjithmonë me oraret e programeve të studimit, në funksion të studentëve dhe pedagogëve.
Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.	

Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit tëstudimeve; **Kriteri 2** Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit; **Kriteri 3** Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve; **Kriteri 4** Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator. **Kriteri 5** Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, linguistikë, arkitekturë, inxhienieri, ekonomi, mjekësi, programestimulimi për shkencat sociale etj. **Kriteri 6** Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.	Vlerësojmë se institucioni ka një bazë të pasur logjistike në funksion të realizimit të programit të studimeve nga studentët dhe pedagogët. Kjo bazë logjistike është cilësore dhe përbëhet nga:32 PC për studentët; 1 laborator me PC për studentët; 26 PC për stafin akademik; 5 PC për administratën; 5 printer kombinat stacionar rrjeti dhe 2 lokal;3 fotokopje kombinat stacionare rrjeti dhe 12 videoprojektorë. Duke konsideruar numrin e studentëve në vitet objekt vlerësimi (24, 99 dhe 156), vlerësojmë se PC janë të mjaftueshme për mësimdhënien dhe mund të punohet për rritjen e numrit të tyre në raport me numrin e studentëve. Sugjerohet që në këto kompjuterë të përditësohet programi i lidhur me drejtësinë, p.sh., programi i juristit. Auditorët kanë hapësirë te mjaftueshme drite. Të gjitha sallat janë te pajisura me sistem audioviziv komunikimi.Sallat e leksioneve janë te ndërtuara ne formë amfiteatri. Realizimi i programit siguron kriterin e sipërfaqes 3 m² per student. Laboratori i informatikës përmban 17 PC. Është në proces ngritja e klinikës psiko-ligjore. Për të mundësuar zhvillimin e praktikave profesionale, institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi dhe mirëkuptimi me disa institucione tësistemit të drejtësisë dhe institucione të tjera të administratës publike. Pjesë e marrëveshjeve është edhe ofrimi i mjediseve të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e këtyre praktikave. Përmes realizimit të projekteve të bashkëpunimit janë rritur aftësitë praktike të studentëve. Këto praktika synojnë tëshërbejnë për identifikimin e studentëve dhe punësimin e tyre në të ardhmen.

<u>Konkluzione të GVJ:</u>

Institucioni ka siguruar një literaturë të pasur, në ndihmë të studentëve, në Bibliotekën e SHLP Mesdhetare e Shqipërisë, e cila është lehtësisht e aksesueshme nga studentët dhe në funksion të përmbushjes së objektivave të programeve të studimit.Pasurimi i bibliotekës kryhet në përputhje me kërkesat e studentëve dhe stafit akademik. Shërbimi i internetit ka rritur aksesin e studentëve në literaturën më të fundit.Institucioni ka mbështetur me një fond të caktuar pasurimin e Bibliotekës me tituj dhe autorë të rinj, me qëllim përditësimin e literaturës që i ofrohet studentëve dhe stafit pedagogjik me zhvillimet e fundit.

Institucioni ofron infrastrukturën e nevojshme për mbarëvajtjen e procesit mësimor. Baza logjistike është e pasur dhe cilësore.Laboratorë, kompjuterë, videoprojektorë, pajisje të ndryshme të teknologjisë së informacionit si dhe sisteme audiovizive komunikimi janë të vlefshme në këtë institucion. Ambientet e mësimdhënies përmbushin standardet e dritës dhe higjienës.

Vlerësohet si arritje pozitive lidhja e marrëveshjeve me disa institucione bashkëpunuese me qëllim kryerjen e praktikave të studentëve dhe eksesin e tyre në tregun e punës.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Tregues të matshëm:

☑ Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi **(në përqindje):**

- Grantet për kërkim
- Konsulencat, shërbimet
- Tarifat për dhe gjatë shkollimit
- Sponsorizimet
- Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm)
- Donacionet, aktivitetet siguruese, fondacione etj
- Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj)

Tabela 8

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në pesë vitet e fundit

NR	Te Ardhurat nga	Vitet				
		2010	2011	2012	2013	2014
A	Fonde Publike					
1	Pushteti qëndror					
2	Pushteti vendor					
	Gjithsej					
B	Fonde joPublike					
1	Grantet për kërkime dhe kontratat					
2	Konsulencat dhe shërbimet					
3	Tarifat për dhe gjatë shkollimit	15,848.00	40,539.40	94,397.41	107,400.97	132,118.40
4	Sponsorizimet			2,049.80		
5	Shërbimet trajnuese(kualifikimi ivazhdueshëm)					
6	Donacionet, aktivitetet siguruese, fondacione					
7	Aktivitetet tregëtare (mensa, Kafe, bare, rezidencat etj)				768.84	650.84
	Gjithsej	15,848.00	40,539.40	96,447.21	108,169.81	132,769.24
	Shuma	15,848.00	40,539.40	96,447.21	108,169.81	132,769.24

☑ Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Tabela 9

Shpenzimet në pesë vitet e fundit sipas burimit të financimit

NR	Shpenzimet	Vitet														
		2010			2011			2012			2013			2014		
		Paga	Shpenzime	Investime	Paga	Shpenzime	Investime	Paga	Shpenzime	Investime	Paga	Shpenzime	Investime	Paga	Shpenzime	Investime
A	Fonde Publike															
1	Pushteti qëndror															
2	Pushteti vendor															
	Gjithsej															
B	Fonde joPublike															
1	Grantet për kërkime dhe kontratat															
2	Konsulencat dhe shërbimet															
3	Tarifat për dhe gjatë shkollimit	13,951.50	23,961.70	2,114.00	11,662.10	41,540.40	22,656.10	24,963.00	68,334.50	5,987.00	30,265.80	68,131.30	890	30,265.20	83,170.40	8,379.60
4	Sponsorizimet								2,049.80							
5	Shërbimet trajnuese(kualifikimi ivazhdueshëm)															
6	Donacionet, aktivitetet siguruese, fondacione															
7	Aktivitetet tregëtare (mensa, Kafe, bare, rezidencat etj)															
	Gjithsej	**13,951.50**	**23,961.70**	**2,114.00**	**11,662.10**	**41,540.40**	**22,656.10**	**24,963.00**	**70,384.30**	**5,987.00**	**30,265.80**	**68,131.30**	**890**	**30,265.20**	**83,170.40**	**8,379.60**
	Shuma	**13,951.50**	**23,961.70**	**2,114.00**	**11,662.10**	**41,540.40**	**22,656.10**	**24,963.00**	**70,384.30**	**5,987.00**	**30,265.80**	**68,131.30**	**890**	**30,265.20**	**83,170.40**	**8,379.60**

☑ Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

<u>Vlerësimi sipas Standardeve</u>

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE **Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumeton gjendjen e tij financiare.**	
Kriteri 1 Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij; **Kriteri 2** Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj; **Kriteri 3** Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion	Institucioni kryen auditimin e situatës së tij financiare në mënyrë të vazhdueshme, duke paraqitur të gjithë zërat e pagave, shpenzimeve operative, etj. Ndonëse, burimet e mundshme financiare të parashikuara në ligjin për organizatat jofitimprurëse janë të ndryshme, de fakto, burimet kryesore financiare të institucionit

të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.	janë "tarifat për dhe gjatë shkollimit" si edhe "aktivitetet tregtare". Të ardhurat e siguruara nga "tarifat për dhe gjatë shkollimit" kanë shënuar një rritje të dukshme në vitet e fundit. Të ardhurat e siguruara nga aktivitetet tregtare janë të kufizuara dhe kanë shënuar rënie. Institucioni nuk ka siguruar të ardhura në pesë vitet e fundit nga fondet publike, si nga pushteti qendror, ashtu edhe ai vendor. Në lidhje me fondet jo publike, nuk janë siguruar të ardhura nga "Grantet për kërkimet dhe kontratat", "konsulencat dhe shërbimet", "shërbimet trajnuese", "donacionet", "aktivitetet siguruese", dhe "fondacionet".Edhe "sponsorizimet" kanë qenë të kufizuara dhe kanë përbërë burim të ardhurash vetëm gjatë vitit 2012.
VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR **Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.**	
Kriteri 1 Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë tëhollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare; **Kriteri 2** Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike; **Kriteri 3** Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	SHLP Mesdhetare e Shqipërisë është projekt i OJF "Qendra Mesdheu" dhe në bazë të statutit harton raporte të përvitshme financiare të cilat i paraqiten Bordit të Qendrës Mesdheu çdo vit. SHLP Mesdhetare e Shqipërisë është projekt i OJF "Qendra Mesdheu", e cila funksionon bazuar në Ligji Nr. 8788, "Për Organizatat Jo Fitimprurëse" dhe Ligji nr. 8789, "Për Regjistrimin e Organizatave Jo Fitimprurëse". Bordi i "Qendra Mesdheu" është autoriteti vendimmarrës në hartimin e politikave financiare dhe vendimmarrjen për menaxhimin e burimeve në SHLP Mesdhetare e Shqipërisë. Raportet financiare të institucionit janë të dokumentuara. SHLP Mesdhetare e Shqipërisë ka dokumentuar raportet financiare të pasqyruara në bilancin financiar të përgatitur nga AIEI Auditors dhe Auditimi i brendshëm për vitet 2009 e në vijim. Ndonëse SHLP Mesdhetare e Shqipërisë dëshmon garancitë e nevojshme financiare në llogaritë e veta bankare, gjenerimi i të ardhurave nga institucioni ka nevojë të rritet. Rritja e numrit të studentëve dhe "tarifat për dhe gjatë shkollimit" si burim kryesor i të ardhurave janë shprehje e përpjekjeve për qëndrueshmëri të institucionit. Qëndrueshmëria e institucionit do të rritej nëse shtohet larmishmëria e burimit të të ardhurave. Organizata jofitimprurëse "Qendra Mesdheu" mund të jetë më aktive në sigurimin e fondeve sponsorizimeve, etj. Shihet që e

	gjithëveprimtaria për ngritjen e fondeve është përqendruar tek rektorati dhe pronari. Gjenerimi i të ardhurave kërkon staf të specializuar në ngritjen e fondeve, thithjen e donacioneve dhe menazhimin e granteve të ndryshme.

Konkluzione të GVJ:

Institucioni harton raporte financiare të përvitshme të cilat i paraqiten Bordit dhe janë të dokumentuara. Raportet financiare i nënshtrohen auditimit të brendshëm dhe të jashtëm.

Të ardhurat dëshmojnë për një qëndrueshmëri financiare gjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimit.

Ka nevojë për një dokument politikash të qarta që do të mundësonin rritjen e gjenerimit të fondeve dhe qëndrueshmërinë financiare të institucionit.

Nevojitet një pluralitet i subjekteve që ngrenë fonde, për kërkime, trajnime etj.

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Tregues të matshëm:

- ☑ Të dhëna për anëtarët e NJSBC

Tabela 10

	Anëtarët e NJSBC	Detyra që ka në NJSBC	Sa kohë ka në këtë detyrë
1	Magi Cici	Specialiste	1 vit
2.	Andi Teqja	Koordinator	2 vjet
3.	Laura Xhaxhiu	Specialiste për punën kërkimore	1 muaj

- ☑ Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:
  - o Sa anketime kanë bërë me studentët
  - o Sa studentë janë anketuar
  - o Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë
  - o Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm
  - o Etj
- ☑ Kontrolli i brendshëm i cilësisë
- ☑ Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti
- ☑ Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre
- ☑ Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike
- ☑ Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE **Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.**	
Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve; **Kriteri 2** Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional; **Kriteri 3** Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë; **Kriteri 4** Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta: Të tërthorta: a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve; b. Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; c. Pyetje konceptuale; d. Intervista; e. Etj. Të drejtpërdrejta: a. Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara); b. Dëgjime në auditor; c. Vlerësimi me nota/pikë; d. Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë; e. Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet); f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; g. Etj.	Programet e studimit janë hartuar duke mbajtur parasysh qët'u paraprijne nevojave që paraqet tregu i punës në Shqipëri.(shih pikën I) Format e drejtpërdrejta të vlerësimit janë kryer në përputhje me syllabusin e lëndëve. Disa prej tyre janë: testimet paraprake dhe përfundimtare, vlerësime të angazhimit të studentëve në seminare, vlerësime të eseve të përgatitura nga studentët, të cilat kanë ndihmuar për vlerësimin e të kuptuarit konceptual, aftësive të të shkruarit, etj, brainstorme, dëgjime në auditor, vlerësime me nota/pikë si në provimin me shkrim të ndërmjetëm, ashtu edhe në provimin me shkrim përfundimtar. Vlerësoj faktin se, verifikimi i vazhdueshëm i dijeve të marra nga studentët është kombinuar me vlerësimin përfundimtar. Në vlerësimin përfundimtar, frekuentimi vlerësohet me pikë dhe influencon në notën e secilit student. Mësimi i lëndës zhvillohet me leksione dhe seminare, vlerësimi i të cilave ndikon në vlerësimin përfundimtar.
VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË **Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.**	
Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve; **Kriteri 2** Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë; **Kriteri 3** Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron; **Kriteri 4** Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe	Në mbështetje të Rregullores së SHLP, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe zhvillimit të kurrikulave u sugjeron departamenteve dhe dekanatit të Fakultetit, të organizojnë përdorimin e metodave të reja bashkëkohore të mësimdhënies, si instrumente që do të përmirësonin cilësinë. Programi mësimor në degën juridik dhe mësimdhënia kryhet dhe zbatohet me metoda bashkohore, mbi bazën e syllabuseve të miratuara per çdo lëndë. Si forma të kontrollit

mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron; **Kriteri 5** Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to; **Kriteri 6** Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.	dhe vlerësimit të dijeve të studentëve për secilën lëndë përdoren provimi me shkrim ndërmjetës dhe ai përfundimtar, ese-te, pyetje të studentëve në auditor, përdorim të kompjuterëve, mjeteve audiovizive, etj. Në këtë kuptim, në zbatim të programit, ofrohen lidhje interneti në çdo kohë, si për pedagogët në ambientet e tyre përkatëse, ashtu dhe për studentët në laboratorët kompjuterikë apo në bibliotekën e Universitetit. Vlerësojmë se, përdorimi i mjeteve audio -vizive gjatë orës së leksionit ndihmon studentin në kuptimin e qartë të strukturës dhe të përmbajtjes së temës dhe ndihmon memorizimin e koncepteve juridike bazë. Një rëndësi të veçantënë kontrollin e mësimdhënies, zënë vlerësimet që japin studentët në përfundim të çdo lënde përmes pyetësorëve. Këto anketime kryhen para provimit, nga persona të paanshëm dhe përpunohen nga Zyra e Administratorit dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Curriculave. Rezultatet e pyetësorëve diskutohen në mbledhjet e departamentit dhe analizohen arsyet e rezultateve pozitive dhe negative, duke u munduar që të shkëmbehen eksperiencat pozitive dhe të minimizohen ato negative. *Mendoj se është e rekomandueshme plotësimi i pyetësorëve nga studentët on line, me qëllim që studentët të ndjehen tësiguritë mbi ruajtjen e anonimatit tëpyetësorit.Meqenëse Shkolla i krijon këto mundësi objektive, atëherë kjo do të ishte e mundur.* Në mbështetje të Rregullores, nxitja dhe përmirësimi i performancës së mësimdhënies realizohet nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Curriculave, si një strukturë e posaçme, e cila funksionon në përputhje me standardet e vendosura nga APPAL dhe ENQA. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Curriculave kryen këto funksione: a) Vlerëson periodikisht çdo semester efikacitetin e veprimtarive mësimore, kërkimore dhe praktikave profesionale, provimet me shkrim, si dhe në raste të veçanta për kurse të veçanta. b) Ndjek procesin e mësimdhënies dhe evidenton praktikat më të mira si dhe praktikat

	e këqija; c) I propozon Shefit të Departamentit masat përkatëse për promovimin e praktikave më të mira si edhe shmangien e praktikave të këqija; *d)* Propozon organizimin e sesioneve kualifikuese për pedagogët me performancë të ulët. Materialet e vlerësimit periodik të Njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe zhvillimit të curriculave i kalojnë Rektorit dhe Bordit të SHLP. Vlerësimet me shkrim të kontrolleve periodike të cilësisë për mësimdhënien shqyrtohen në një nga mbledhjet e Senatit tëSHLP dhe vendimet për përmirësimin e gjendjes merren në Senat. - SHLP vlerësonprogramet e studimeve edhe nga treguesit e punësimit të të diplomuarve të secilit program.

<u>Konkluzione të GVJ:</u>
Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve, tëdrejtpërdrejta dhe të tërthorta.
Nxitja dhe përmirësimi i performancës së mësimdhënies realizohet nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Curriculave, e cila ka proceduar si një strukturë e posaçme.

SHLP Mesdhetare ndërgjegjëson personelin dhe studentët për këtë fakt për rëndësinë cilësisë së programeve dhe mësimdhënies, por nuk është e qartë se si është realizuar dhe si do të realizohet në vijimësi ky ndërgjegjësim.

Kontrolli i brendshëm dhe vlerësimet e studentëve përmes pyetësorëve janë disa nga format e vlerësimit të procesit të mësimdhënies. Senati i Shkollës ka rol aktiv në këtë proces, analizon dhe merr masa për përmirësimin e situatës.

<u>POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE</u>

7. Programii studimit, organizimi i tij

<u>Pjesa përshkrimore</u>

> **Terma reference**: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj.

SHLP Mesdhetare e Shqipërisë ka në themel të punës kërkimore shkencore, respektim rigoroz të procedurave të kërkuara dhe urdhëruara nga ligji për arsimin e lartë dhe MAS. Kurrikulat janë pjese kryesore e njësive drejtuese në këtë institucion, duke bërë të mundur arritjen e një programi bashkëkohor. Një pjesë e stafit të angazhuar është me përvojë dhe me grada mësimore. Vihet re një nxitje e kërkimit shkencor dhe pjesëmarrje nga ana e pedagogëve në aktivitete shkencore. U konstatua se punohej me kujdes për informiminestudentëve mbi programin e studimit. Informacion jepej mbi kreditet, lëndët, organizimin dhe të drejtat e garantuara nga kjo shkollë, në kuadër të arsimit të lartë në Shqipëri.

Tregues të matshëm:

- ☑ Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi
- ☑ Organizimi i programittë studimit (vite, semestra, javë etj.)
  - o 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
  - o 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor
  - o 1 ECTS ç 25 orë mësimore punë të studentit
  - o 1 orë mësimore ç 50'
- ☑ Në Planet mësimore të jepet ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë

- ☑ Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:
  - Për leksionet ____ orë në auditor dhe ____ orë punë e pavarur e studentit
  - Për Seminaret ____ orë në auditor dhe ____ orë punë e pavarur e studentit
  - Për Laboratorët ____ orë në auditor dhe ____ orë punë e pavarur e studentit
  - Për Praktikat lëndore ____ orë në auditor dhe ____ orë punë e pavarur e studentit
  - Për Praktikën Profesionale ____ orë në auditor dhe ____ orë punë e pavarur e studentit
  - Provimi përfundimtar ____ orë në auditor dhe ____ orë punë e pavarur e studentit

☑ Ndryshimet nëPlanet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara

Lëndë/Module		Semestri	ECTS	Orë mësimore															Provime
				Leksione			Seminare			Laborator			Praktikë						
				ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	Punë e Pavarur	Orë në auditor	Punë e Pavarur	Gjithsej	
1	Lënda 1 (Ishte)																		
	Lënda 1 (u ndryshua)																		
2	Lënda 2 (Ishte)																		
	Lënda 2 (u ndryshua)																		
Ndryshime në Total																			

Institucioni nuk ka kryer ndryshime në programin e licensuar. Planet mësimore përditësohen në përputhje me nevojat e tregut dhe me kërkesë të Departamentit përkatës. Pedagogët e lëndës kryejnë përditësimin e syllabuseve duke reflektuar tendencat e fundit të zhvillimit të fushës dhe mendimit shkencor.

☑ Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës (Tabela6)

Lënda /Moduli		Pedagogu/ët Përgjegjës	Titulli/grada kualifikimi	Departamenti	Statusi PAE apo PAK
1.	Lënda 1				
2.	Lënda 2				

3.	....				

☑ Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Bazuar në syllabuset e përzgjedhura, vlerësoj se ato përfshijnë të gjithë elementët e sipërpërmendur dhe janë në përputhje me planin mësimor të programit të studimit Bachelor në Juridik. Bashkëngjitur një shembull syllabusi i përdorur.

Nga intervistat me pedagogët u konstatua se është në praktikën e institucionit që syllabuset të përditësohen duke u azhornuar me prurjet më të reja në fushën e shkencës. Megjithatë, në Departamentin Juridik kemi pasur vetëm një program studimi tre-vjecar me sillabuse të miratuara qysh me fillimin e tij. Sidoqoftë, ndryshime dhe përditësime të tyre janë bërë në fillim tëçdo viti akademik. Kanë njëQendër të Kërkimit e Zhvillimit shkencor, e cila organizon diskutime dhe debate për çështje të ndryshme, në lidhje me botimet më të fundit nga autorë vendas apo të huaj, me qëllim që ky informacion të përfshihet në punën mësimore të institucionit nëpërmjet syllabuseve. Vlerësojmë faktin se, në çdo fillimi viti shkollor, syllabuset rishikohen dhe u vihen në dispozicion studentëve si në mënyrë fizike ashtu edhe on-line.

☑ Dokumentacioni përkatës, i marrë në institucion

<u>Vlerësimi sipas Standardeve</u>

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA **Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.**	
Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS); **Kriteri 2** Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të	Programi i studimit në degën e Drejtësisë, në nivelin Bachelor, i ofruar nga SHLP Mesdhetare e Shqipërisë është program i akredituar. Programi i studimit është i organizuar në module dhe vlerësohet me ECTS Kredite. Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një vitit nga një

plotë është 60 kredite;	student që ndjek këtë Program është 60 ECTS Kredite.
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE **Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.**	
Kriteri 1 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve; **Kriteri 2** Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër; **Kriteri 3** Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit; **Kriteri 4** Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.	Vlerësoj se, institucioni ofron informacionin e nevojshëm për përmbajtjen e Programit të studimeve Bachelor në Juridik, për syllabuset, për numrin e orëve dhe kreditet, pedagogët dhe format e mësimdhënies, format e vlerësimit, literaturën e detyrueshme dhe ndihmëse, ngarkesën mësimore, praktikat, orët laboratorike, detyrimet e studentëve në lidhje me frekuentimin, në përputhje me statutin dhe rregulloren e shkollës. Informimi i studentëve dhe personave të interesuar përbën një detyrë funksionale të Departamentit Juridik, duke mundësuar kështu rritjen e përgjegjshmërisë në përmbushjen e saj. Informimi për lëndët e detyrueshme dhe lëndët me zgjedhje, synon të ndërgjegjësojë studentët mbi rolin që kanë këto lëndë në formimin e tyre dhe përgatitjen për të ardhmen. Aktorë të rëndësishëm në rritjen e nivelit të informacionit janë drejtuesit e dekanatit, Departamenti Juridik, Njësitë mësimore shkencore, sekretaria mësimore dhe Zyra e Informacionit. Institucioni mundëson edhe informimin on line në lidhje me programin e studimit. Theksojmë se në të gjithë sistemin arsimor juridik, ka nevojë për të përcaktuar grupin e lëndëve bazë të detyrueshme, me kreditit më të larta, që do të mbahen parasysh në një mesatare të ponderuara. Për këtë ka nevojë për rregullime nënligjore të përgjithshme.

<u>Konkluzionet e GVJ:</u>

Programi i studimit në degën e Drejtësisë, në nivelin Bachelor, i ofruar nga SHLP Mesdhetare e Shqipërisë është program i akredituar, i organizuar në module dhe i vlerësuar në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Një student grumbullon mesatarisht gjatë një viti 60 ECTS.
Vlerësoj se institucioni ka një strategji mbi informimin e studentëve dhe personave të interesuar mbi programin e Studimit, syllabuset, literaturën e detyrueshme dhe mbështetëse, qëllimin e tyre dhe rolin në formësimin e studentëve. Ky informacion është i akesueshëm, jo vetëm në formë fizike por edhe on line.

Syllabuset janë përgatitur me përgjegjshmëri dhe profesionalizëm nga pedagogët e lëndëve. Rifreskimi i syllabuseve dhe përditësimi i tyre me arritjet më të fundit brenda dhe jashtë vendit përbën një nga arritjet e institucionit, duke e përcaktuar këtë si një detyrë në kontratën e punës dhe duke ushtruar kontrollin e nevojshëm në përmbushjen e saj.

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Mësimdhënia organizohet në përputhje me Programin e Studimit Bachelor në Juridik të miratuar. Leksionet dhe seminaret janë format konkrete kryesore të organizimit të saj, të shoqëruara me praktikat profesionale dhe orët e konsultimit.Pedagogët gjatë intervistimit treguan se nxisin njëpjesëmarrje aktive, si gjatë leksioneve ashtu edhe gjatë seminareve përmes prezantimit nga pedagogu tëçështjeve kryesore për diskutim dhe marrjes së mendimit të studentëve në lidhje me to. Përmes këtij procesi, pedagogu i seminareve identifikon çështje ende të paqarta për studentët dhe përforcon njohuritë e studentëve përmes rishpjegimit të tyre. Me qëllim një mësimdhënie ndëraktive dhe forcimin e vetëvlerësimit tek studentët, nxiten të kryhen referime nga studentët, gjatë seminareve. Janë dhënë edhe detyra me shkrim për studentët. Studentët deklaruan se këtu kanë mësuar për herë të parë se si të punojnë në grup. Vlerësimi i kryer nga pedagogu gjatë seminareve është pjesë e vlerësimit përfundimtar të studentëve.

Ngarkesa mësimore është e ndarë ndërmjet pedagogëve sipas normave mbi ngarkesën mësimore që duhet të ketë çdo pedagog. Shpërndarja e lëndëve në departament është bërë bazuar në kualifikimin e pedagogëve, pa cenuar cilësinë e mësimdhënies. Ndodh që ka pedagogë që japin dy lëndë. Mendojmë se kjo nuk e cenon cilësinë. Rritja e numrit tëlëndëve për një pedagog, mund të sillte rreziqe për cenimin e cilësisë.

Në lidhje me kontrollin e njohurive, angazhimi i studentëve në seminare përbën 10% të vlerësimit përfundimtar të lëndës, provimet e ndërmjetme përbëjnë 20% të vlerësimit të të gjithë lëndës. Si alternativë e provimeve të ndërmjetme janë përdorur edhe punimet e temave ose detyrave të kursit që në vlerësim zënë të njëjtën përqindje me provimin e ndërmjetëm. Provimi përfundimtar zë pjesën më të madhe të kontrollit të njohurive të studentëve dhe vlerësohet me 70% të pikëve totale. Sugjerohet qëçdo syllabus, format e vlerësimit të studentëve të shoqërohen edhe me përqindjet përkatëse në raport me vlerësimin përfundimtar të lëndës (nuk ishin me përqindje tek syllabusi model që mora)

Metodat e mësimdhënies janë karakterizuar nga një larmishmëri në zhvillim dhe dinamikë. Metodat klasike të mësimdhënies janë shoqëruar me metoda të reja. Disa nga metodat e përdorura janë:

- Auditorët e hapur me të ftuar. Pjesëmarrja e kolegëve lektorë dhe personaliteteve të shquara në fushën e drejtësisë ka ndihmuar në forcimin e njohurive të studentëve dhe sidomos në profilizimin e njohurive të tyre;
- Seminare ndëraktive të shoqëruara me diskutime dhe debate mbi çështje të parashtruara nga përmbajtja e lëndës;
- Brain store, që kanë konsistuar në ndërtimin e mendimit duke u mbështetur në argumente thelbësore, në grupe të vogla prej disa studentësh;
- Brainstorm, nxjerrja e përfundimeve të shpejta duke analizuar një argument të caktuar nga ana e pedagogut, por që u është dhënë studentëve për interpretim analitik dhe argumentiv.

- Përgatitje të eseve nga studentët dhe prezantime të studentëve para një audience të gjerë studentësh dhe pedagogësh;

- Kryerja e disa punimeve nga studentët, mbështetur në një kërkim të thelluar hulumtues dhe literaturë të orientuar nga pedagogët. Punimet e përgatitura nga studentët u janë shpërndarë elektronikisht studentëve të tjerë, me qëllim pjesëmarrjen aktive në diskutime dhe debate mbi çështjet e trajtuara.

- Laboratoret dhe praktikat synojnë të rrisin aftësimin praktik të zbatimit të njohurive të fituara nga studentët.

Ngarkesa totale në auditor për Format e mësimdhënies në Programin e studimit Bachelor në Juridik, **Tabela 11**

Bachelor në juridik me profile		
Format e mësimdhënies		Orët totale në auditor
a.	Leksione	1050
b.	Seminare	735
c.	Praktikë profesionale	120
d.	Orë konsultime	20
	Në total	2925

Duke synuar një mësimdhënie sa më cilësore, institucioni përdor forma të ndryshme të vlerësimit të brendshëm. Disa nga format e vlerësimit të brendshëm janë:

- Ndjekja **e** orëve të ndryshme të mësimit nga përgjegjësit e departamentit të drejtësisë si dhe nga dekani i fakultetit të shkencave juridike dhe politike. Përfundimet e kontrollit u janë referuar drejtuesve më të lartë të institucionit me qëllim marrjen e masave për rritjen e cilësisë së mësimdhënies.

- Janë mbledhur dhe vlerësuar sugjerime dhe vërejtje nga studentët për pedagogë të ndryshëm dhe lëndë të ndryshme, përmes plotësimit nga ana e tyre tëpyetësorëve. Vërejtjet dhe sugjerimet e mbledhura janë bërë objekt diskutimi dhe janë analizuar sipas standardeve që duhet të përmbushë arsimi i lartë.

- **<u>Tregues të matshëm:</u>**

  ☑ Llojet e Formavetë mësimdhënies, për lëndët/modulet:

  - Leksione
  - Seminare
  - Ushtrime
  - Laboratore
  - Praktikë lëndore
  - Praktikë profesionale
  - Etj

  ☑ Format e kontrollit të njohurive

Tabela 12

Format e kontrollit të njohurive janë përcaktuar qartë në syllabuset përkatëse.

Bachelor në juridik		
Format e kontrollit		Sa pjesë e vlerësimit total të studentit ka
a.	Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive	Ndjekja e lëndës në programin bachelor Juridik është e detyrueshme vetëm për seminaret. Për frekuentimin dhe angazhimin konkret në seminare studenti vlerësohet me 10% të vlerësimit total.
b.	Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit)	Një detyrim alternativ i provimit të ndërmjetëm që organizohet në mes të çdo semestri është edhe realizimi i detyrave të kursit. Kjo është e përcaktuar qartë në syllabusin e lëndës, së miratuar nga Departamenti. Studenti vlerësohet me 20% të vlerësimit total të lëndës, për kryerjen e detyrës së kursit.
c.	Testimet gjatë vitit	Nëpërmjet syllabusit, pedagogët e lëndëve kanë përcaktuar qartë nëse kanë përzgjedhur të vlerësojnë njohuritë e studentëve nëpërmjet provimit të ndërmjetëm ose detyrës së kursit. Provimi i ndërmjetëm përbën 20% të vlerësimit total të lëndës.
d.	Provimi përfundimtar	Provimi përfundimtar përbën 70% të vlerësimit total të lëndës. Studentëve që për arsye të motivuara nuk kanë mundur të marrin pjesë në testimin e ndërmjetëm u është dhënë mundësia të vlerësohen me një tezë provimi 100 pikë.
	Në total	100%

- ☑ Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë përbën një pjesë të rëndësishme të formimit të studentëve dhe përgatitjes së tyre për të ardhmen. Disa nga format e aktivizimit të studentëve pranë këtij institucioni janë:

- Pjesëmarrja aktive e studentëve në aktivitete të ndryshme të organizuara nga Departamenti Juridik;
- Puna e pedagogëve me një grupe të studentëve më të përgatitur, duke i bërë pjesë të punës shkencore që kryhet në Departament;
- Njohja nga studentët e praktikës juridike përmes ndjekjes nga afër të punës në gjykatat e rretheve gjyqësore ose prokuroritë përkatëse;

Vlerësoj se numri i studentëve të angazhuar në aktivitetin e njësisë, si në projektet shkencore në nivel Departamenti, Fakulteti, në bashkëpunim me institucione të tjera apo në punimet

shkencore individuale të pedagogëve është i limituar, në raport me numrin total të studentëve që ndjekin studimet në këtë institucion; Kjo ka ndodhur edhe për shkak të mosintegrimit të plotë në këto aktivitetet të studentëve të transferuar.

Vlerësoj se numri i studentëve të angazhuar në projekte shkencore në nivel Departamenti, krahasuar me angazhimin e studentëve në punime shkencore individuale të pedagogëve,është i kufizuar dhe raporti ka nevojë të përmirësohet. Një perceptim na jep tabela që vijon, ku duket qartë se aktivizimi në nivel departamenti është i ulët.

Tabela në vijim jep të dhëna mbi angazhimin e studentëve në aktivitetin shkencor të IAL.

Tabela 13

	Aktiviteti shkencor i IAL	**Numri i studentëve të aktivizuar**
1	Për punime shkencore individuale të pedagogëve	11 studentë
2	Për projekte shkencore në rang Departamenti	1 student
3	Për projekte shkencore në rang Fakulteti	-
4	Për projekte shkencore në bashkëpunim me të tjerë	5 studentë

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Tregues të matshëm:

- ☑ Procedurat e pranimit të studentëve
- ☑ Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve
- ☑ Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë)
- ☑ Nota Mesatare
- ☑ Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse)
- ☑ Nota Mesatare
- ☑ Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend
- ☑ Të dhëna për punësimin e studentëve
- ☑ Numri total të diplomuarve
- ☑ Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)
- ☑ Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)
- ☑ Etj

Vlerësoj se institucioni ka përcaktuar qartë procedurat e pranimit të studentëve.

Tabela 14

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

2 vitet e fundit, duke u nisur nga viti që po bëhet RVB	Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë)	Nota Mesatare
2013	24	6.11
2014	99	6.74
2014 (Viti i III)	156	6.51

Tabela 15

Numri total i studentëve dhe kalueshmëria e tyre në vite

Programi i studimit	Numri total i studentëve	Kalueshmëria në total	Nota mesatare për numrin total të studentëve
Bachelor në Juridik	338	89%	6.65

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE **Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëpritjes së studentëve të rinj.**	
Kriteri 1 Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi. **Kriteri 2** Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.	Pranimi i studentëve kryhet në përputhje me Ligjin nr.9741, datë 21.05.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi. Procedurat e pritjes së studentëve të rinj përfshijnë verifikimin e dokumentacionit të paraqitur si, dokumentet e identifikimit dhe dokumente të përfundimit të shkollës së mesme. Pjesë e këtij procesi është informimi i detajuar i studentëve të rinj dhe prindërve të tyre me parimet, rregullat e funksionimit të institucionit tonë dhe detyrimet reciproke të palëve. Gjithashtu, i kushtohet rëndësi njohjes së tyre me pedagogët e institucionit, si dhe me mjediset e shkollimit. Vlerësoj se, studentëve u lihet kohë e mjaftueshme për të vendosur nëse do të ndjekin studimet në këtë institucion. Me qëllim marrjen e një informacioni sa më të detajuar mbi Programin e studimit, studentët e rinj kanë mundësi të vizitojnëwebsitin e institucionit. Në përfundim dosja e çdo

	studenti arkivohet dhe ruhet e dixhitalizuar. Një tjetër formë e tërheqjes së studentëve në këtë institucion është kryerja e vizitave nga pedagogët në shkollat e mesme në Tiranë dhe rrethe. Në këto vizita, prezantohen programet e studimit dhe ftohen nxënësit të vizitojnë ambientet e IAL. **Nota mesatare e studentëve të regjistruar në këtë IAL, pavarësisht një rritjeje të lehtë në vite është relativisht e ulët, rreth 6.1-6.7.** **Vlerësoj si një tregues të cilësisë së procesit të vlerësimit të studentëve ruajtjen e notës mesatare pothuajse në të njëjtin nivel me notën mesatare të shkollës së mesme, 6.6.** I ndërgjegjshëm për këtë cilësi të studentëve të rinj në hyrje, institucioni është përpjekur të përdorë forma të ndryshme të tërheqjes së nxënësve që kanë përfunduar me një mesatare më të lartë shkollën e mesme. Një nga format e përdorura ka qenë ofrimi i bursave të plota dhe të pjesshme për nxënësit që kanë përfunduar me rezultate të larta shkollën e mesme. Por, gjykoj se kjo formë duhet shoqëruar me forma të tjera aktive, sepse numri i nxënësve që kanë përfunduar me rezultate të mira, të cilët tërhiqen nëpërmjet kësaj forme është i limituar dhe nuk arrin të sjellë ndryshimin nëprurjet më të mira nëinstitucion. Vlerësim pozitiv shpreh për faktin se, Institucioni është i orientuar nga shtresat në nevojë dhe ka kontribuar me mbulimin e plotë të shpenzimeve për individë nga këto shtresa në nevojë, për fëmijët e policëve të vrarë në detyrë, por edhe për nxënës nga Lugina e Preshevës. Meriton të përmendet se institucioni ofron bonuse financiare për PAK dhe një infrastrukturë të përshtatshme për akomodimin dhe lëvizjen e individëve paraplegjik që lëvizin me karroca. Sugjeroj që, rregullime të posaçme për shtresat në nevojë duhet të ketë edhe në Rregulloren e institucionit, kur të përcaktohet përshtatja e arsyeshme, si dhe mënyra e vlerësimit të studentëve që nuk mund të shkruajnë, mënyra e punës së pavarur të pedagogut, etj.
Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit.	

Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve; **Kriteri 2** Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit; **Kriteri 3** Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës; **Kriteri 4** Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.	Konstatova se studentët ishin të mirinformuar mbi programin, kohëzgjatjen, ngarkesën mësimore dhe pedagogët që e zhvillojnë atë, format e mësimdhënies dhe kontrollit të dijeve, literaturën e detyrueshme dhe ndihmëse, etj. Akesimi *on line* i syllabuseve dhe ofrimi i informacionit të detajuar nga stafi për të interesuarit gjatë kohës së pranimeve të reja,janë përdorur për të rritur nivelin e informacionit të studentëve të rinj. Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përdor anketimet e studentëve si një formë të rëndësishme vlerësimi. Përfundimet e klasifikuara dhe respektimi i anonimatit shoqërojnëprocesin. Gjetjet e anketimeve u bëhen të njohura strukturave përkatëse në institucion. Shërbimi i këshillimit të karrierës iu ofrohet studentëve. Është krijuar rrjeti i Studentëve ALUMNI, punësimi i të cilëve është konsideruar si njohje e punës dhe besueshmërisë së këtij institucioni në tregun e punës. Ka studentë të programit Bachelor në juridik,që janë atashuar me kohë të pjesshmepranë disa zyrave të avokatisë, për të përftuar eksperiencë.
Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.	
Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë; **Kriteri 2** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademiknë të cilin zhvillohet programi i studimeve; **Kriteri 3** Institucion disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.	Vlerësoj se Sekretaria në këtë institucion mban elektronikisht dhe në mënyrë shkresore të dhëna korrekte për numrin e studentëve në hyrje, në vitet e ndërmjetme dhe në përfundim. Në kuadrin e transferimeve të studentëve nga institucionet e mbyllura të arsimit të lartë jo publik, janë respektuar procedurat e nevojshme, në lidhje me vlerësimin e krediteve, kornizat kurrikulare,regjistrimi i studentëve në librin e matrikulimit në MAS. Tëdhëna për studentët e diplomuar për herë të parë gjatëvitit akademik 2014-2015 janë regjistruar dhe arkivuar. Në përfundim, vlerësoj se institucioni disponon të dhëna të plota për ecurinë e studentëve ose largimet para përfundimit të programit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit, Statutin dhe Rregulloren e

	Institucionit. Studentët mund të marrin rezultatet e çdo lënde në tre vitet akademike të nivelit Bachelor apo vlerësimin në provimin përfundimtar/ose diplomë, si në mënyrë shkresore ashtu edhe elektronike.
Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.	
Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor; **Kriteri 2** Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.	Institucioni është i orientuar nga kujdesi për studentin. Janë vendosur orë dhe ditë të caktuara për këshillimin e studentëve nga stafi. Zyra e këshillimit të karrierës në bashkëpunim me Departamentin përkatësluajnë një rol aktiv nëcaktimin e institucionit në të cilin do të kryhet praktika mësimore nga studentët.Marrëveshjet e institucionit me dy kompani të cilat punojnë për bashkëpunimin me institucionet apo dikasteret, ku do të kryhet praktika profesionale kanë përbërë një garanci të lehtësimit të këtij procesi. Këto kompani janë: "Headhunter" si dhe studio ligjore "Shoqata e Ndërmjetësimit". Në kryerjen e praktikave mësimore, studentët ndiqen nga pedagogët të cilët i ndihmojnë që të përfitojnë sa më shumë nga përvoja në institucionet ku kryejnë këto praktika. Një nga përvojat pozitive më të fundit është ajo e vitit akademik 2014-2015, gjatë të cilit praktika mësimore u organizua në bashkëpunim me USAID-in, duke iu dhënëmundësi studentëve tëmerrnin pjesë në gjyqe imituese, si dhe të vëzhgonin sistemin e audio-recordit në gjykata, i cili u vendos me mbështetjen e USAID-it.

<u>Konkluzionet e GVJ</u>

SHLP Mesdhetare e Shqipërisë i kushton kujdes punës me studentët, duke filluar që nga rekrutimi i tyre dhe deri në përmbylljen e studimeve.Vëmendje e veçantë i kushtohet tërheqjes së studentëve përmes ofrimit të informacionit të detajuar mbi programin e studimit, syllabuset, bibliotekën, punën shkencore, praktikat mësimore, mundësitë për punë, etj si edhe përmes organizimit të stafit të institucionit në shkollat e mesme në Tiranë dhe rrethe, si dhe ditëve të hapura për nxënësite shkollave të mesme, në ambientet e institucionit.

Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.

Disponon të dhëna për praktikën mësimore. Zyra e Këshillimit për Karrierën bazuar në vlerësimin e prirjeve dhe interesave të studentëve dhe në bashkëpunimin Departamentin përkatës, ndjek institucionin në të cilin studenti do të kryejë praktikën mësimore. Gjatë kryerjes

së praktikave mësimore, studentët mbikëqyren nga pedagogët, me qëllim përfitimin nga përvoja pranë institucioneve të sistemit të drejtësisë.

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Tregues të matshëm:

- ☑ Të dhëna për kërkimin shkencor
- ☑ Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL
- ☑ Numri i projekteve kërkimore të fituara
- ☑ Numri i projekteve të zbatuara
- ☑ Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL
- ☑ Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda iAL
- ☑ Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor
- ☑ Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor
- ☑ Numri i Çmimeve Kombëtare
- ☑ Dokumentacioni përkatës i marrë gjatë vizitave

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Tregues të matshëm:

- ☑ Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar
  - Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare
  - Numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj
  - Numri i pjesëmarrësve në trajnime fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit
  - Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt IAL

- Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor
- Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore Jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime

Tabela 16

Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar

Aktivitete shkencore individuale dhe në rang Institucioni në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar në pesë vitet e fundit		
1	Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare	5
2	Numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj	18 orë mësimore
3	Numri i pjesëmarrësve në trainime fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit	4
4	Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt IAL	Reth 200
5	Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor	
6	Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore Jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime	20
7	Numri i Çmimeve ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.	1

Tabela 17

Të dhëna të tjera për kërkimin shkencor

Aktivitete të planifikuara individuale dhe në rang Institucioni në pesë vitet e fundit		
1.	Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL	110 botime
2.	Numri i projekteve kërkimore të fituara	-
3.	Numri i projekteve të zbatuara	13 projekte
4.	Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL	3 konferenca shkencore ndërkombëtare
5.	Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda iAL	Të gjithë pedagogët e departamentit të drejtësisë kanë marrë pjesë në aktivitetet shkencore të organizuara nga Universiteti Mesdhetar.
6.	Numri i kërkimit shkencor me procesin	Të gjithë pedagogët e

	mësimor	departamentit të drejtësisë zhvillojnë kërkim shkencor lidhur me procesin mësimor sipas fushës përkatëse të studimit.
7.	Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor	17studentë(Punimet janë në proces)
8.	Numri i Çmimeve Kombëtare	-

☑ Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë:

- Institucionet qeveritare bashkëpunuese
- Organizatat Profesionale
- Komuniteti i biznesit, tregu i punës

Tabela 18

Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë.

Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese		
Institucionet qeveritare bashkëpunuese		Lloji i bashkëpunimit
	Ministri	Praktikë mësimore
	Institucione shtetërore	Praktikë mësimore
	Institucione të sistemit të drejtësisë	Praktikë mësimore
Organizatat Profesionale		Lloji i bashkëpunimit
	Dhoma e tregtisë dhe e industrisë Tiranë	Kualifikimi dhe punësimi i studentëve të diplomuar në UMSH si dhe realizimi i projekteve të përbashkëta
	B&T Sistem	Kualifikimi dhe punësimi i studentëve të diplomuar në UMSH si dhe realizimi i projekteve të përbashkëta
	Instituti i modelimeve në biznes	Kualifikimi dhe punësimi i studentëve të diplomuar në UMSH si dhe realizimi i projekteve të përbashkëta
	Dhoma Kombëtare e Avokatisë	Kualifikimi dhe punësimi i

		studentëve të diplomuar në UMSH si dhe realizimi i projekteve të përbashkëta
	BNT Elektronics	
	Qëndra për Zhvillimin dhe Demokratizimin e Institucioneve	Kualifikimi dhe punësimi i studentëve të diplomuar në UMSH si dhe realizimi i projekteve të përbashkëta
	A&D Business Consulting	Kualifikimi dhe punësimi i studentëve të diplomuar në UMSH si dhe realizimi i projekteve të përbashkëta
Komuniteti i biznesit, tregu i punës		Lloji i bashkëpunimit
	Dhoma e tregëtisë dhe e industrisë Tiranë	Kualifikimi dhe punësimi i studentëve të diplomuar në UMSH si dhe realizimi i projekteve të përbashkëta
	B&T Sistem	Kualifikimi dhe punësimi i studentëve të diplomuar në UMSH si dhe realizimi i projekteve të përbashkëta
	Instituti i modelimeve në biznes	Kualifikimi dhe punësimi i studentëve të diplomuar në UMSH si dhe realizimi i projekteve të përbashkëta
	Dhoma Kombëtare e Avokatisë	Kualifikimi dhe punësimi i studentëve të diplomuar në UMSH si dhe realizimi i projekteve të përbashkëta
	BNT Elektronics	Kualifikimi dhe punësimi i studentëve të diplomuar në UMSH si dhe realizimi i projekteve të përbashkëta
	Qendra për Zhvillimin dhe Demokratizimin e Institucioneve	Kualifikimi dhe punësimi i studentëve të diplomuar në UMSH si dhe realizimi i projekteve të përbashkëta
	A&D Business Consulting	Kualifikimi dhe punësimi i studentëve të diplomuar në UMSH si dhe realizimi i projekteve të përbashkëta

☑ Dokumentacioni përkatës

<u>Vlerësimi sipas Standardeve</u>

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME **Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.**	
Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit; **Kriteri 2** Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.	Shkëmbimi i informacionit është përdorur nga institucioni që të nxitet bashkëpunimi midis anëtarëve të personelit brenda institucionit, si në procesin e hartimit të programit ashtu edhe në mbikëqyrjen e realizimit të tij. U konstatua ndarje e qartë e detyrave ndërmjet pedagogëve në Departamentin Juridik dhe analizë e vazhdueshme e punës. Pedagogët u shprehën se kanë një frymë bashkëpunimi në departament.
Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.	
Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj; **Kriteri 2** Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë; **Kriteri 3** Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit; **Kriteri 4** Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Vlerësoj se institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione të ndryshme dhe aktorë të biznesit vendas. Këto marrëdhënie kanë përbërë një bazë mbështetëse për kryerjen e praktikave mësimore nga studentët. Është mbështetur mobiliteti i personelit akademik dhe studentëve në nivel ndërkombëtar, përmes mbështetjes financiare të pjesëmarrjes në aktivitete të ndryshme. Aktivitetet shkencore të rëndësishme janë financuar dhe janë organizuar nga vetë Shkolla. Nuk jemi të qartë se sa është nr i rasteve të tilla pozitive dhe sa është buxheti i vendosur për këto raste. Departamenti Juridik përgatit një raport mbi përfitimet nga marrëveshjet kontraktuale, nëfunksion të realizimit të programeve të studimit në fushën juridike.

Konkluzionet e GVJ:

Shkolla ka mjete për shkëmbimin e informacionit ndërmjet pedagogëve dhe ka nxitur bashkëpunimin midis anëtarëve të personelit të institucionit në procesin e hartimit të programit dhe në mbikëqyrjen e realizimit të tij.

Institucioni ka mbështetur marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, në funksion të realizimit të Programit të Studimit. Këto bashkëpunime i kanë shërbyer kryerjes së praktikave mësimore nga studentët, organizimit në bashkëpunim me to të trajnimeve profesionale, si dhe të aktiviteteve të ndryshme shkencore.

Janë kryer raportime analitike me qëllim vlerësimine rezultatit të arritur nga këto bashkëpunime në funksion të realizimit të Programit të Studimit.

Nuk kemi të dhëna të plota se sa është nr i rasteve të aktiviteteve në bashkëpunim me institucioneve të tjera dhe sa është buxheti i vendosur në dispozicion për këto raste.

ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR IMPLEMENTIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

RVJ mbyllet me **"Analizën përmbledhëse të RVJ"** sipas metodës **SWOT** (**S**trengths-pikat e forta, **W**eaknesses- pikat e dobëta, **O**pportunities-mundësitë, **T**hreats-pengesat).

a. Pika të forta:

1. Programi i Studimit në SHLP Mesdhetare e Shqipërisë është hartuar bazuar në përvojën më të mirë mësimore dhe akademike të vendit dhe ato të huaja. Syllabyset nuk janë statike por përditësohen në fillim tëçdo viti, me zhvillimet më të fundit. Metodat klasike janë gërshetuar me metodat bashkëkohore;
2. Kombinimi i pedagogëve me përvojë me stafin e ri përbën një pikë të fortë të institucionit. Rekrutimi i stafit të institucionit ndjek procedura ligjore dhe transparente dhe vlerësimi i stafit pedagogjik kryhet bazuar në kritere të përcaktuara qartë.
3. Puna e institucionit është e orientuar për nga grupet në nevojë duke i mbështetur me bursa në vazhdimësi;
4. Institucioni ofron një infrastrukturë të përshtatshme dhe miqësore për grupe të caktuara të studentëve PAK;
5. Institucioni ka ndërtuar një kulturë të hapur bashkëpunimi me institucione të tjera dhe aktorë të ndryshëm të biznesit në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar. Ky bashkëpunim synon qartë realizimin e objektivave të Programit të Studimit.
6. Nota mesatare në hyrje e nxënësve që kanë përfunduar shkollën e mesme ruan qëndrueshmërinë e saj dhe nuk ndryshon edhe në përfundim të studimeve nga studentët e nivelit Bachelor Juridik, duke shprehur qartë një vlerësim objektiv nga pedagogët.
7. Institucioni ofron një infrastrukturë bashkëkohore që respekton dritën, largësinë nga zhurmat, sipërfaqen në m2 dhe m2 për studentë, etj.
8. Përdormi i metodave interaktive për aktivizimin e studentëve në debate gjatë procesit të mësimdhënies, si dhe në diskutimet për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe cilësinë.
9. Nga intervistat me studentët, në një pjesë të konsiderueshme të tyre, duket qartë sensi kritik që ata kanë zhvilluar, si ndaj problemeve në institucion, ashtu edhe ndaj vlerësimit të vetë punës së tyre;
10. Zgjerimi i mobilitetit për studentët (sidomos në dalje), stafit mësimor akademik dhe atij menaxhues është pjesë e aktivitetit të SHLP Mesdhetare e Shqipërisë. Ky zgjerim do të bëjë që marrëdhëniet e institucionit me rrjete universitare si EURAS (Euro – Asian Universities Union) dhe EMUNI (Rrjeti i universiteteve të vendeve të Mesdheut) do të forcohen.

Pika të dobëta:

1. Nota mesatare në hyrje është rreth 6.6. Edhe prurjet e studentëve nga institucione të tjera nuk sollën efekte pozitive por vetëm e përforcuan këtë tregues. Metodat e përdorura për

ndryshimin e kësaj situate dhe rritjen e prurjeve nga nxënës që kanë përfunduar shkollën e mesme me rezultate më të larta kanë rezultuar të pamjaftueshme dhe jo efektive. Kjo notë mesatare relativisht e ulët e nxënësve që vijnë nga shkollat e mesme reflektohet edhe në nivel të pamjaftueshëm të gjuhës së huaj si edhe në cilësinë e studentëve në përfundim të studimeve të nivelit Bachelor.

2. Nota e ulët mesatare e studentëve në hyrje sjell efekte kufizuese edhe në angazhimin e studentëve në aktivitete shkencore; Nuk krijon një pluralitet frytdhënës me studentë shumë të mirë, të mirë e mesatarë. Në përgjithësi në të tria vitet është ruajtur niveli i studentëve mesatarë dhe nën mesatarë.
3. Niveli i pakënaqshëm i gjuhës së huaj sjell efekte negative në përdorimin e literaturës bashkëkohore në gjuhë të huaj. Programet shtesë për mësimin e gjuhës së huaj të ofruar nga institucioni kanë rezultuar të pamjaftueshme, duke konsideruar se përmirësimi i nivelit të gjuhës së huaj kërkon një kohë të caktuar. Kjo sjell mosshfrytëzimin si duhet të mundësisë së mobilitetit të studentëve, përdorim të kufizuar të literaturës së huaj, si dhe pjesëmarrje të kufizuar në aktivitete ndërkombëtare;
4. Nivel i pamjaftueshëm i formimit për të arsyetuar dhe shkruar në gjuhën shqipe, është prezent tek një masë studentësh, të cilët kanë vështirësi të shkruajnë qartë e në mënyrë korrekte. Kjo mund të ketë efekte kufizuese në angazhimin e tyre në aktivitete shkencore dhe në procesin e mësimit;
5. Numri i studentëve të angazhuar në aktivitetin shkencor të IAL është i kufizuar. Kjo mund të jetë përveç të tjerave e lidhur edhe me notën mesatare relativisht të ulët dhe nivelin e pamjaftueshëm të formimit për të arsyetuar dhe shkruar qartë, si dhe të gjuhës së huaj.
6. Mungesa e një stafi të specializuar për gjenerimin e fondeve;
7. Institucioni nuk ka mundur të gjenerojë fonde nga trajnimet dhe shërbimet ose të sigurojë fonde të tjera. Të ardhurat e siguruara nga tarifat, për dhe gjatë shkollimit,si dhe të ardhurat e siguruara nga aktivitetet tregtare janë ndër burimet kryesore të të ardhurave të institucionit.

b. Mundësitë:

1. Aplikime për projekte , duke shfrytëzuar thirrjet për organizata jofitimprurëse në fushën e drejtësisë. Këto thirrje kanë konsistuar si në thirrje për fonde publike ashtu edhe donacione të ndryshme;

2. Në bashkëpunim me Misionin e OSBE-së në Tiranë, Departamenti Juridik në SHLP Mesdhetare e Shqipërisë do të ngrenë një klinikë ligjore, e cila do t'u ofrojë pa pagesë informacione ligjore të gjithë të interesuarve. Ngritja dhe Funksioni i kësaj klinike do të rrisë aftësitë praktike të studentëve pranë këtij institucioni dhe do të forcojë orientimin e tij për nga grupet në nevojë; Kjo do të sjellë përfshirje më të gjerë të pedagogëve dhe studentëve në projekte për kërkim zhvillim.

3. Të njihen mirë mundësitë e reja që ofrohen nga zhvillimi i legjislacionit.

c. Pengesat:

1. Konkurrenca midis IAL-ve, sidomos me ato publike.

2. Numri i lartë i të diplomuarve në Fakultetin Juridik të Universiteteve të ndryshme, mund të ulë interesin për ndjekjen e këtij Programi studimi.

3. Paqartësia e vazhdimësisë në sigurimin e fondeve.

Sygjerojmë:

- Të ketë kritere më të forta në pranimin e studentëve në lidhje me notën mesatare dhe notën mesatare në lëndë të caktuara, me qëllim krijimin e grupeve të ndryshme të studentëve sipas mesatares (studentë me nivel note të lartë e mesatar);
- Të ketëkriter për njohjen e gjuhës së huaj nga studentët.
- Të ketë përcaktime të qarta kohore për kualifikimin e stafit akademik në proces.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm

1. Prof. Dr. Aurela Anastasi